



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

PROJEKTVENDIM

Nr 1402, Datë 28 / 01 / 2021

Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2021

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04. 2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të VKM nr.1034, datë 16.12.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për rirforcimin e Pallatit të Kulturës *Dedë Ndue Lazri*, Bashkia Lezhë”; dhe të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kryetari i Bashkisë i paraqet projektin përkatës Këshillit të Bashkisë,

Për të vendosur :

1. Miratimin e një shtesë e ndryshim në buxhetin e bashkisë për vitin 2021 si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2021 në shumën 104,000,000 lekë.

2/2-Të shtohet shpenzimet në programin buxhetor “Trashëgimia kulturore, eventet artistike e kulturore në shumën 104,000,000 lekë, fond i cili do të përdoret për: a-Punime ndërtimi në shumën 101,540,493 lekë; b-Mbikëqyerje punimesh në shumën 2,277,321 lekë; dhe c-Kolaudim dhe përgatitje të dokumentacionit përfundimtar në shumën 182,186 lekë.

Veprimet të kryhen në : Gr.00, Prog.08220, Kap.01, Art.231 në shumën 104,000,000 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Pjerin NDREU

